



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019, e konform nenit 17 paragrafi 1, lidhur me paragrafin 2, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 15 dhe 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë-----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për formimin e komisionit

Neni 1

Formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, për parcelën P-72116046-01211-0, sipas vendimit paraprak 01-Nr-016-18863, të datës 28.03.2024 të miratuar nga Kuvendi i Komunës në Suharekë.

Neni 2

Komisioni nga neni 1, (një) i këtij vendimi përbehet prej 5, (pesë) anëtarëve dhe do të jetë kjo përbërje:

- 2.1 -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 2.2 -----përfaqësues/e nga Kuvendi i Komunës
- 2.3 -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.4 -----përfaqësues/e nga Ekzekutivi i Komunës
- 2.5 -----përfaqësues/e nga sektori jo qeveritar

Neni 3

Komisioni do të kryen punën pas marrjes së vendimit paraprak nga Kuvendi i Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Detyrat dhe përgjegjësit e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara me dispozita ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-10/2019”, komisioni ka autoritet, mandat dhe kompetencë të bëjë njoftimin publikë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, ndarjen e parcelës, kushtet dhe kriteret specifik gjatë konkurrimit të hapur.

Neni 5

Obligohet zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, ti zhvillojnë procedurat e konkurrimit të hapur, shprehjes së interesit dhe vlerësimin e ofertave.

Neni 6

6.1 Për punën që do ta kryej komision do të kompensohet nga 50€, për çdo mbledhje (seancë) që do ta mbajë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Suharekës.

6.2 Anëtarët e komisionit të lartcekur nuk mund të paguhën më shumë se 6, (gjashtë) mbledhje (seanca) të cilat mbahen brenda viti kalendarik.

Neni 7

Kuvendi i Komunës në Suharekë, e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtareve të komisionit kur do herë që kërkohet.

Neni 8

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____

Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI